



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF - GOVERNMENT



Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit  
Telecommunications Regulatory Authority  
Regulativni Autoritet Telekomunikacije

ART - RAT - T

10 JAN 2008

Nr. 008/08

## RREGULLORE PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKORDIMIN E SË DREJTËS PËR SHFRYTËZIMIN E RADIO FREKUENCAVE

### Neni 1 Baza juridike

Kjo rregullore është nxjerr në bazë të nenit 4 par. 4, nenit 20, 22 par.1,3, nenit 28 par. 2 dhe nenit 29 par.1 dhe 2 të Ligjit mbi Telekomunikacionin, UNMIK/ Rreg. 2003/16.

### Neni 2 Objekti i rregullorës

Objekt i kësaj rregullore është përcaktimi i procedurës së kërkimit, procedimit dhe akordimit të së drejtës për shfrytëzimin e radio frekuencave.

### Neni 3 Fusha e zbatimit

Kjo rregullore vlen për të gjithë shfrytëzuesit potencial të radio frekuencave. Shfrytëzues të radio frekuencave konsiderohen të gjithë personat juridik, vendas apo të huaj, të cilët janë të regjistruar në organet kompetente për këtë lloj shërbimi dhe të cilët kërkojnë shfrytëzimin e radio frekuencave apo të cilëve i nevojiten këto frekuenca në bazë të licencës për operim të lëshuar po ashtu nga ART.

### Neni 4 Procesi për dhënien e licencës për shfrytëzimin e radio frekuencave.

4.1 Të gjithë aplikuesit për licencën për shfrytëzimin e radio frekuencave duhet të dorëzojnë në Departamentin për Menaxhimin e Frekuencave (në tekstin në vijim DMF) në kuadër të ART dokumentet e mëposhtme:

- 1) aplikacionin për radio frekuenca, sipas formularit (aneksi I i kësaj rregulloreje);
- 2) çertifikatën e regjistrimit si subjekt fizik/juridik dhe pjesën shtesë informatë mbi biznesin;
- 3) çertifikatën e regjistrimit në organin tatimor;
- 4) vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilin vërtetohet se subjekti nuk i ka borxh këtij organi, nëse subjekti është regjistruar më parë.

4.2 Për ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit kërkohet vetëm licenca për operim e lëshuar nga ART.

4.3 DMF do të shqyrtoj gjithë materialin e paraqitur me rastin e aplikimit për çdo rast në veçanti dhe sipas nevojës do të mbaj dialog me secilin aplikant në mënyrë që të kuptoj qartë kërkesën e tij.

4.4 DMF do të njoftoj aplikantin për pranimin e aplikacionit brenda 14 (katërbëdhjetë) ditëve. Nëse aplikanti nuk merr ndonjë përgjigje brenda kësaj periudhe, atëherë ai mund të kërkoj nga DMF informata për t'u siguruar nëse aplikacioni është pranuar.

DMF ka të drejt të kërkoj informata shtesë për të sqaruar informatat e marra.

4.5 Miratimi apo refuzimi i licencës do të bëhet nga DMF brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të aplikacionit në rastet e nevojshme ky afat mund të zgjatet edhe për 30 (tridhjetë) ditë.

4.5.1 Kur DMF konsideron se janë plotësuar të gjitha kushtet për dhënien e licencës për akordimin e të drejtës për shfrytëzimin e frekuencave, njofton me shkrim aplikuesin e po ashtu edhe me afatin e pagesës së çmimit të licencës.

Kjo pagesë duhet të bëhet brenda 15 dite nga dita e njoftimit, në rast të kundërt konsiderohet sikur aplikuesi ka hequr dorë nga kërkesa/aplikacioni.

4.5.2 DMF do të refuzoj akordimin e të drejtës për shfrytëzim të radio frekuencave në rast se:

- (a) ART nuk ka në dispozicion radio frekuencat e kërkuara;
- (b) radio frekuencat e kërkuara përfshihen në ato breze frekuencash, dhënia e të cilave sipas Ligjit për Telekomunikacion i nënshtrohet zbatimit të procedurave të veçanta, jashtë përcaktimit të kësaj rregullore;
- (c) nuk ka radio frekuenca të lira;
- (ç) kërkesa e aplikantit nuk është teknikisht e arritshme;
- (d) akordimi i së drejtës do të ishte në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;
- (f) akordimi i së drejtës për shfrytëzim të radio frekuencave nuk do të lejonte shfrytëzimin efektiv të spektrit të radio frekuencave apo të veprimit/punës së pajisjeve të tjera të telekomunikacionit;
- (g) aplikanti ka thyer kushtet e këtij ligji apo nuk ka përmbushur obligimin për pagimin e tarifave për shfrytëzimin e radio frekuencave;



(h) nëse në akordimin e të drejtave për shfrytëzimin e radio frekuencave, një sinjal nga pajisja e radios do të shkaktonte pengesa të papranueshme në radio pajisjet e tjera, në pranuesit e tjerë apo sistemet elektrike apo elektronike.

(i) ART ka prova të mjaftueshme se:

ii) aplikanti nuk ka besueshmëri dhe njohuri të specializuara profesionale, që kërkohen për ushtrimin e licencës,

iii) si rezultat i dhënies së licencës, rrezikohet rendi publik ose sigurimi kombëtar.

4.6 Procesi i licencimit përveç çështjeve të tjera, duhet të siguroj që të licencuarit të jenë të kualifikuar siç definohet me ligj, të jenë të sigurt financiarisht, teknikisht kompetent dhe të aftë t'i përgjigjën Ligjit për Telekomunikacion ashtu që ART të jetë në gjendje të përmbush obligimet e saj dhe të ushtroj të drejtën në bazë të Ligjit për Telekomunikacion.

4.7. Vlerësimi i çdo aplikacioni do të bëhet në bazë të kriterëve të paraqitura më lartë. Kur licenca të lëshohet, i licencuari do të futet në listën që ART e mban.

### **Neni 5**

#### **Licenca**

Licenca e lëshuara nga DMF mund të lëshohet për shfrytëzimin e një ose më shumë kanaleve frekuencore.

Licenca është e vlefshme vetëm për subjektin e licencuar.

### **Neni 6**

#### **Tarifa për shfrytëzimin e radio frekuencave.**

6.1 Tarifa do të përcaktohet në bazë të Rregullorës për Tarifimin e Spektrit Frekuencor.

6.2 Tarifa duhet të paguhet pas njoftimit nga DMF, të paraparë me nenin 4.5.1 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 7**

#### **Kohëzgjatja e licencës dhe përtëritja**

7.1 Kjo licencë lëshohet për periudhën 1 (një) vjeçare .

7.2 Pas skadimit të periudhës 1 (një) vjeçare, i licencuari mund të ripërtërij licencën.

7.3 Në rast se i licencuari kërkon ripërtirjen e licencës këtë duhet ta bëjë brenda 30 (tridhjetë) dite para skadimit të së drejtës, nëse kërkesa nuk bëhet brenda kësaj periudhe kohore i licencuari humb të drejtën e ripërtirjes andaj duhet të aplikoj përsëri.

7.4 Licenca e lëshuar në rastet e ripërtirjes hynë në fuqi pas skadimit të licencës paraprake.

**Neni 8  
Sanksionet**

Në rast të shkeljes së këtyre dispozitave të përcaktuara me këtë rregullore ART vendos sanksione në përputhje me Ligjin për Telekomunikacion.

**Neni 10  
Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hynë në fuqi datën e nënshkrimit dhe sipas nevojës mund të amendamentohet.

Prishtinë  
Datë 10.01.2008



*Anton Berisha*  
Anton Berisha, Kryetar  
Autoriteti Regulator i Telekomunikacionit





**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF - GOVERNMENT**



**Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit  
Telecommunication Regulatory Authority  
Regulativni Autoritet Telekomunikacije**

**FORMA E APLIKIMIT PER FREKUENCE**

Njesia kerkuese/Organizata	
Pika e kontaktit, Adresa	
Tel. No./Fax. No./E-Mail	

**SPECIFIKIMET E TË DHËNAVE:**

010. LLOJI I VEPRIMIT (N=KERKESE E RE; R=RIPERTËRIRJE)	
102. NUMRI SERIK I AGJENSIONIT (Procesues)	
110. FREQUENCA E KERKUAR (Range/No./Separation)	
113. KLASA E STACIONIT (Fikse/Mobile);	
114. GJERËSIA E BREZIT DHE PËRCAKTIMI I TRANSMETIMIT	
115. FUQIA E TRANSMETUESIT (ne Wat)	
130. KOHEZGJATJA E PERDORIMIT	
140. DATA E FILLIMIT	
141. DATA E SKADIMIT	
144. TREGUESI I REKORDIT	
205. TIPI I AGJENSIONIT	
207. NJESIA OPERUESE	

**STACIONI A**

300. VENDI FREKUENCA TRANSMETUESE QE PERDORET Tx	
301. LOKACIONI I ANTENES Tx (Emri i Sajtit)	
303. KOORDINATAT E ANTENES Tx (Six-Figure Grids)	
306. RREZEVEPRIMI I AUTORIZUAR (në kilometra)	
340. FORMA DHE MODELI I PAJISJES	
354. FORMA, LLOJI DHE MODELI I ANTENES	
356. LARTESIA E ANTENES (në metra mbi nivelin e tokës)	
357. PERFORCIMI I ANTENES (në dB)	
360. GJERESIA E TUFES SE ANTENES (H/V)	
362. ORIENTIMI I ANTENES (V/H)	
363. POLARIZIMI I ANTENES	

**STACIONI B**

400. VENDI FREKUENCA PRANUESE QE PERDORET Rx	
401. LOKACIONI I ANTENES Rx (Emri i Sajtit)	
403. KOORDINATAT E ANTENES Rx (Six-Figure Grids)	
440. FORMA DHE MODELI I PAJISJES	
454. FORMA, LLOJI DHE MODELI I ANTENES	
456. LARTESIA E ANTENES (në metra mbi nivelin e tokës)	
457. PERFORCIMI I ANTENES (ne dB)	
460. GJERESIA E TUFES SE ANTENES (H/V)	
462. ORIENTIMI I ANTENES (V/H)	
463. POLARIZIMI I ANTENES	

502. NUMRI IDENTIFIKUES I GRUPIT (nëse nevojitet)	
520. FREKUENCA DUPEKSE QIFTOHET ME	
702. NUMRI SERIAL I AGJENSIONIT	
704. LLOJI I SHERBIMIT (S=Simplex; D=Duplex; H=Semi-Duplex)	
801. ARSYETIMI (qëllimi i kërkesës për frekuencë)	
803. PERSONI KONTAKTUES (emri, numri i telefonit)	
804. INKREMENTI I AKORDIMIT	
996. LLOJI I QARKUT (RPTR, LOS, M-LINK, B'CAST, CNR)	

Print (emri, mbiemri):

Nënshkrimi i aplikantit: \_\_\_\_\_

Data e pranimit në ART:

Pranuar nga: Nënshkrimi: \_\_\_\_\_